



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:159011

Datë: 28.12.2023

Numri i dokumentit: 05133281

**P.nr. 589/23**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM**, sipas Gjyqtarit të vetëm gjykues Veton Ademaj, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Kaltrina Rexhepi - Imami, në çështjen penale kundër të pandehurës E.T. nga fsh. Q. K. P, e akuzuar për shkak të veprës penale *lëndimi i lehtë trupor* nga neni 185 par.3 nën par. 3.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr. 1196/23, të datës 21.07.2023, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar, me datë 12.12.2023, në praninë e prokurorit të shtetit L. H, të pandehurës E.T, mbrojtëses së viktimave Z.B, në të njëjtën ditë bie dhe shpalli publikisht, ndërsa me datë 28.12.2023, përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**E pandehura:**

**E. (S.) T**, e lindur në fsh. D.K. P, me datë...., tani me vendbanimin në fsh. Q. K. P, nga babai S. T, dhe nëna Sh. T, e vajzërisë K, e identifikuar në bazë të numrit personal....., e gjendjes së dobët ekonomike, amvise, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

**ËSHTË FAJTOR**

**S e p s e**

Me datë 08.04.2023, rreth orës 17:00, në fshatin Q. K. P, personit tjetër i shkakton lëndime të lehta trupore, i cili rezulton me dëmtim të përkohshëm të shëndetit dhe atë viktimës së ndjeshme, fëmijës E. P, i moshës trembëdhjetë (13)vjeçar, në mënyrën që, gjersa viktimja ishte duke qëndruar në rrugë me të birin e të pandehurës, me të arritur aty e pandehura e cila pretendon se viktimja i ka rrahur të birin, të njëjtin e godet me shuplaka në kokë, duke i shkaktuar ndrydhje të indeve të buta të kokës.

- me çka ka kryer veprën penale ‘lëndimi i lehtë trupor’ nga neni 185 par. 3 nën par. 3.1 të KPRK-së.

Gjykata konform nenit 7, 38, 39,40,42, 46 par. 1 pika 1.1, 47, 48, 49, 69, 70, nenit 185 par.3, nënpar.3.1 të KPRK-së dhe nenit 364 të KPPRK-së të pandehurës i shqipton:

**Dënim me burgim** në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cilin dënim ndaj të pandehurës nuk do të ekzekutohet nëse brenda periudhës verifikuese prej 2 (dy) vite, nuk do të kryej veprën tjetër penale.

E pandehura lirohet nga detyrimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale.

Pala i dëmtuar E. (Sh.) P. nga fsh. Q. K. P, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm, me datë 21.07.2023, ka parashtruar aktakuzën PP/II.nr.1196/23, ndaj të pandehurës E.T, për shkak të veprës penale ‘lëndimi i lehtë trupor’ nga neni 185 par. 3 nën par. 3.1 të KPRK-së.

Gjykata mbajti shqyrtimin fillestar me datë 12.12.2023, në praninë e prokurorit të shtetit L. H, të pandehurës E.T. dhe mbrojtëses së viktimave Z.B, ka munguar pala i dëmtuar i mituri E. P. së bashku me përfaqësuesin ligjor, të njëjtit janë ftuar në mënyrë të rregullt, mirëpo të njëjtit nuk janë paraqitur dhe mungesën nuk e kanë arsyetuar.

Gjykata konform dispozitave të nenit 240 të KPPK-së, e ka udhëzuar të pandehurën me të drejtat e saja, ku në këtë rast e pandehura ka deklaruar se i ka kuptuar të drejtat e saja dhe se për mbrojtës nuk do të angazhojë ngase nuk ka nevojë.

Pas leximit të aktakuzës PP/II.nr.1196/23 të datës 21.07.2023 nga prokurori i shtetit, gjyqtari i vetëm gjykues pasi që është i bindur se e pandehura e ka kuptuar aktakuzën, i është dhënë mundësia që të deklarohet në lidhje me pranimin ose mospranimin e fajësisë, duke e njoftuar për rëndësinë e pranimin të fajësisë dhe pasojat e mospranimin.

E pandehura E.T. deklarojë që e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, ndihet i penduar dhe premtoj se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra tjera penale, duke shtuar se me palën e dëmtuar i kanë përmirësuar raportet dhe vullnetarisht e bënë pranimin e fajësisë pa kurrfarë presioni.

Prokurorja e shtetit në lidhje me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurës, deklarojë që pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe ka mbështetje në provat materiale të cilat gjinden në shkresa të lëndës, duke i propozuar gjykatës që të e aprovojë pranimin e fajësisë dhe të e marr si rrethanë lehtësuese.

Mbrojtësja e viktimave deklarojë që e përkrah në tërësi fjalën e prokurorit të shtetit, dhe pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurës.

Gjyqtari i vetëm gjykues, është i bindur, se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurës është bërë konform dispozitave të nenit 242 par. 2 të KPPRK-së nën par. 2.1,2.2,2.3, 2.4 dhe paragrafit 6 të KPPRK-së, pasi që e pandehura e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes dhe provat në të cilat edhe mbështet aktakuza, edhe atë: raporti fillestar i incidentit nr. rasti..., i datës 08.04.2023, raporti i oficerit L. P. nr. rasti..., i

datës 08.04.2023, raporti i hetuesit K. K, i datës 08.04.2023, procesverbali i marrjes në pyetje i të pandehurës E.T. dhënë në Stacionin Policor në Pejë, me datë 08.04.2023, nr. rasti ..., raporti mjekësor , i lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm në Pejë, me datë 08.04.2023, nr. rendor të protokollit ..., në emër të E. P, nr. rasti ....., akt ekspertimi mjekoligjor i datës 19.07.2023, në emër të të dëmtuarit E. P, lëshuar nga Dr. F. B. – specialist i mjekësisë ligjore, si dhe shkresat e tjera të lëndës, andaj gjykata mori aktvendim me të cilin pranohet pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurës E.T. për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.3, nënpar.3.1 të KPRK-së.

Me faktet e ofruara, si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurës është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurës E.T. qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.3, nënpar.3.1 të KPRK-së.

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të të pandehurës ashtu që e njëjta është penalisht përgjegjëse. Sa i përket fajësisë së të pandehurës, e njëjta është e vetëdijshme për veprën e kryer dhe atë e ka kryer me dashje.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 70 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurën gjykata ka konsideruar: pranimin e fajësisë, keqardhjen e shfaqur nga ana e të pandehurës, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra tjera penale, ndërsa rrethana rënduese ndaj të pandehurës gjykata gjeti moshën e re të të dëmtuarit.

Sipas bindjes së gjyqtarit, dënimi i shqiptuar, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurës. Gjyqtari i vetëm gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe ka të bëjë rehabilitimin e tyre; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimin mbi lirimin nga shpenzimet e procedurës penale të të pandehurës gjykata e bazoi në nenin 452 par. 4 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK), pasi gjatë procedurës nga ana e të pandehurës është prezantuar kartela e lëshuar nga Qendra për Punë Sociale në Pejë, me numër të regjistrimit 6853 e datës 28.08.2023 e evidentuar në emër të V. P. kartelë kjo e cila ka afatshmëri deri më 30.11.2024 duke u vërtetuar se e pandehura E.T. figuron si anëtare e familjes e përfituesit të ndihmës sociale, prandaj gjykata vlerëson se me ngarkimin e shpenzimeve të procedurës, të pandehurës do të i rrezikohet gjendja materiale e saj.

Gjykata e udhëzoi palën e dëmtuar në kontest civil konform nenit 462 të KPPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 364 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 369 të KPP-së, gjykata e përpiloi këtë aktgjykim.

**P.nr.589/23, datë 28.12.2023**

**Bashkëpunëtore Profesionale**  
Kaltrina Rexhepi - Imami

**GJYQTARI**  
Veton Ademaj

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa,  
në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes,  
Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj gjykate.